



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 321 Akti

Nr. 482 Vendimi
Tiranë, më 7.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Elka Ermenkova, në datën 7.12.2021 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ermira Tafani**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Ermira Tafani gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e prokurores në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*.
- 2.** Subjekti i rivlerësimit Ermira Tafani është shortuar në shortin e datës 12.11.2019, në përputhje me rregulloren e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni). Nga procedura e shortit rezultoi se procesi i rivlerësimit do të kryhet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Genta Tafa (Bungo) dhe Olsi Komici, i cili u zgjodh relator i çështjes.
- 3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administrua raporti i hartuar nga institucioni i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
- 4.** Trupi gjykues i shortuar pranë Komisionit, me vendimin e datës 18.11.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 5.** Komisioni, në datën 3.12.2019, nëpërmjet postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues i kërkoi të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.
- 6.** Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, në datën 13.12.2019, kur është përgjigjur për pyetësonin standard, nuk është shprehur nëse ka konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
- 7.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 11.10.2021, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ermira Tafani për kriterin e pasurisë dhe në datën 18.10.2021 e njoftoi në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit vetëm për kriterin e pasurisë dhe të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes, kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave brenda datës 2.11.2021.
- 8.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 26.10.2021, me rrugë elektronike ka njoftuar Komisionin se po në këtë datë ka depozituar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP) dorëheqjen me shkrim dhe kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit, me qëllim pezullimin e procedurave të mëtejshme në procesin e rivlerësimit ndaj saj si subjekt rivlerësimi. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur edhe kërkesën që i ka drejtuar KLP-së, duke paraqitur dorëheqjen me shkrim nga detyra e prokurorit, duke kërkuar njëkohësisht edhe mbarimin e statusit të magjistratit.
- 9.** Komisioni, në datën 3.12.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar subjektin në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të së drejtës së saj për t’u dëgjuar dhe bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, të shprehë vullnetin nëse dëshiron ose jo të marrë pjesë në seancë dëgjimore, fokusi i së cilës do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

10. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, datë 4.12.2021, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore dhe ka shprehur vullnetin e saj më parë për heqje dorë nga detyra e prokurorit.

11. KLP-ja, me shkresën “Dërgohet vendimi nr. ***, i KLP-së”, të datës 18.11.2021¹, njoftoi deklarin e mbarimit të statusit për shkak dorëheqje të subjektit Ermira Tafani, duke bashkëlidhur edhe vendimin nr. ***, datë 16.11.2021.

12. Me vendimin nr. ***, datë 16.11.2021, KLP-ja ka vendosur:

- a) Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje për znj. Ermira Tafani, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- b) Dorëheqja jep efekt në datën 30.11.2021.
- c) Të njoftohen për këtë vendim znj. Ermira Tafani, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
- d) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

13. Komisioni, me shkresën e datës 1.12.2021², i ka kërkuar informacion Gjykatës Administrative të Apelit nëse ndaj vendimit nr. ***, datë 16.11.2021, të KLP-së është bërë ankim nga subjekti i rivlerësimit Ermira Tafani.

14. Gjykata e Administrative e Apelit, me shkresën e datës 3.12.2021³, ka konfirmuar se deri në datën 2.12.2021 nuk është bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 16.11.2021, të KLP-së, nga subjekti i rivlerësimit Ermira Tafani.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

15. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit Ermira Tafani ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- ii) Procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk ka përfunduar me vendim, sipas pikës 1 të nenit 58 dhe me një nga masat disiplinore respektive: nenit 59 “konfirmim në detyrë”; të nenit 60 “pezullim nga detyra dhe detyrim për të ndjekur programin e trajnimit”; si dhe të nenit 61 “shkarkim nga detyra”.
- iii) Subjekti i rivlerësimit Ermira Tafani ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.
- iv) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë KLP-së, e cila, me vendimin nr. ***, datë 16.11.2021, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit Ermira Tafani, për shkak të dorëheqjes.

¹Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2021, e KLP-së, e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 19.11.2021.

²Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2021, e Komisionit.

³Shkresë nr. *** prot., datë 3.12.2021, e Gjykatës Administrative të Apelit.

17. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes⁴.

18. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

19. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ndër të tjera, ka interpretuar lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

20. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike më 3.12.2021, ka njoftuar subjektin se KLP-ja ka konfirmuar dorëheqjen me vendimin nr. ***, datë 16.11.2021 dhe nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore me fokus përfundimin e procesit të rivlerësimit nëpërmjet aplikim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

21. Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.12.2021, me anë të postës elektronike ka njoftuar Komisionin se heq dorë nga e drejta për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, pasi e ka shprehur më parë vullnetin e saj për dorëheqje nga detyra e prokurorit.

22. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁴“Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para këshillit përkatës. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ermira Tafani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Ermira Tafani si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Suela ZHEGU

Anëtare

Olsi KOMICI

Relator

Sekretare gjyqësore

Olsida Goxhaj